



09 shkurt 2015, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Mamushës rrezikon qëndrueshmërinë e vet financiare

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës online të ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe ka analizuar përmbajtjen e Raportit Vjetor Financiar për vitin 2014.

Bazuar në të dhënat që figurojnë në këtë Raport del se borxhet që duhet të arkëtohen nga Komuna e Mamushës, por edhe faturat e papaguara nga qeveria komunale si pasojë e mungesës së mjeteve, sfidojnë qëndrueshmërinë financiare të këtij pushteti lokal.

Monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë gjetur se borxhet e përgjithshme që duhet të arkëtohen nga Komuna e Mamushës gjatë vitit 2014 kanë arritur në shifrën prej 166 mijë eurosh, në krahasim me vitin 2013 kur shifra arrinte në 150 mijë euro.

Borxhet më të mëdha të paarkëtuara figurojnë nga tatimi në pronë dhe taksa komunale, që përbëjnë zërat kryesorë në të hyrat vetjake të Komunës së Mamushës. As përmirësimi i arkëtimit të tatimit në pronë në vitin 2014 nuk ka mjaftuar që të ulët shumën e borxheve të arkëtueshme. Kjo ngase arkëtimi i taksës komunale (në firma) ka qenë goxha i ulët, gjë që ka ndikuar në rritjen e shumës së borxheve të paarkëtuara.

Borxhi që duhet arkëtuar në emër të tatimit në pronë në vitin 2014 ka zbritur në shumën 75 mijë euro, nga 80 mijë sa ishte në vitin 2013.

Ndërkaq borxhi që duhet arkëtuar në emër të taksës komunale në vitin 2014 është rritur në 91 mijë euro, nga 70 mijë euro sa ka qenë në fund të 2013-ës. Taksa komunale e faturuar për vitin 2014 ka qenë afër 23 mijë e 500 euro derisa gjatë vitit janë arkëtuar vetëm 2 mijë e 200 euro.

Kësisoj, borxhi total që duhet arkëtuar është 166 mijë euro. Vlen të përmendet se kjo shumë është më e lartë sesa shumën prej 146 mijë eurosh, të cilën Komuna e Mamushës në vitin 2014 e ka harxhuar për ndërtimin e rrugëve.

Në anën tjetër, vitin 2014 Komuna e Mamushës e ka mbyllur edhe me fatura të papaguara, në vlerë prej 26 mijë eurosh, me arsyetimin se i mungojnë mjetet financiare, ku 19 mijë euro janë në pozicionin e mallrave dhe shërbimeve, 6 mijë euro te shpenzimet komunale dhe 1 mijë euro te subvencionet.

Bazuar në këto të gjetura, EC Ma Ndryshe vlerëson se Komuna e Mamushës përballet me sfida serioze në arkëtimin e të hyrave vetjake. Mos adresimi i këtij problemi me kalimin e viteve mund të rrezikojë vetëqëndrueshmërinë ekonomike të kësaj komune.

Vërejtje në këtë drejtim ka adresuar edhe Zyra e Auditorit në Raportin e Auditimit të vitit 2013 (që mund të gjendet në linkun: http://oag-rks.org/repository/docs/3_Report_Mamushë_13_ALB_FINISHED_READY_FOR_PRINT_876199.pdf), i cili institucion ka rekomanduar që "Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike

performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final”.

Sipas ZAP-it, “Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguruar se janë ndërmarrë gjithë masat për mbledhjen e këtyre të hyrave”.

Rreziku që parasheh ZAP-i është se “Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi/realizimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm”.

Duke i marrë parasysh këto të gjetura, EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Mamushës që:

- Të merr masa të menjëhershme për përmirësimin e arkëtimit të hyrave vetjake;
- Të hartoj një plan të duhur për arkëtimin efikas të borxheve, por edhe pagesën e faturave të papaguara dhe ta diskutoj atë me publikun;
- Të zbatoj pa asnjë vonesë dhe në përpikëri rekomandimet e ZAP-it.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës” përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.